



MESAZHET E SYNUARA
PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE
ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

**Një burim për hartuesit Kosovarë
dhe ndërkombëtarë të politikave, dhe për shoqërinë civile**

Korrik 2018

Sfondi dhe qëllimi

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar për Kosovë (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata Speciale e Kosovës”) është një “gjykatë hibride”, e cila ka për qëllim gjykimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të tjera që janë kryer ndërmjet 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 dhe që lidhen me pretendimet e shprehura në Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës të vitit 2011. Gjykata Speciale e Kosovës do të gjykojë vetëm rastet ndaj personave individualë. Është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por për shkak të natyrës së ndjeshme të mandatit të saj është zhvendosur në Hagë dhe për personel ka gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Ndonëse puna e Gjykatës mund të sigurojë një masë drejtësie për viktimat dhe një formë të drejtpërdrejtë përgjegjësie për kryesit e krimeve, ndikimi i saj mund të kufizohet rëndë nga dinamikat politike dhe sociale brenda vetë Kosovës dhe të kuptuarit e kufizuar të publikut mbi qëllimin dhe gamën e saj. Këta faktorë mund të kontribuojnë jo vetëm në dëmtimin e ndikimit potencial pozitiv të Gjykatës në shoqëri, por edhe të ushtrojnë efekt destabilizues mbi Kosovën.

Në vitin 2017, Integra, Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT), Impunity Watch, dhe PAX realizuan një hulumtim mbi përceptimin publik të Gjykatës Speciale të Kosovës, i cili identifikoi disa sfida kryesore. Vetëdijësimi i publikut për qëllimin, mandatin dhe fushëveprimin e Gjykatës Speciale të Kosovës është i ulët, situatë kjo që ka mundësuar përhapjen e keqinformatave, duke i rritur kështu mundësitë për një efekt “shokues” pasi të jenë lëshuar aktakuzat e para dhe duke i ulur gjasat e pranimit social të punës së Gjykatës në afat më të gjatë. Derisa shqiptarët e shohin mandatin e Gjykatës për të ndjekur penalisht krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit si të padrejtë dhe të lidhur kryesisht me UÇK-në (me shumicë të gatshme për të protestuar nëse luftëtarët e UÇK-së paditen), serbët besojnë se nuk ka gjasa që Gjykata të sjellë drejtësi për ata që kryenin krime të rënda të luftës. Kështu ekziston rreziku që, nëse puna e Gjykatës rezulton në ndjekjen e suksesshme të anëtarëve të UÇK-së, mund të rriten perceptimet e shqiptarëve për

anshmërinë antishqiptare në ndjekjen e rasteve të krimeve të luftës. Në anën tjetër, nëse Gjykata nuk ia del t'i bëjë të paktën disa dënime, mund të rritet zhgënjimi i serbëve me institucionet e Kosovës. Të dy rezultatet do të kishin efekte negative në marrëdhëniet tashmë të tensionuara ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe, në përpjekjet për të arritur pajtimin, dhe në stabilitetin politik dhe social të Kosovës.

Raporti u përmyll me një sërë rekomandimesh për aktorët kryesorë, me synimin që t'i adresojë disa nga rreziqet e identifikuar nga hulumtimi i perceptimit publik. Një rekomandim qendror ishte se Gjykata Speciale e Kosovës, Qeveria e Kosovës, institucionet kyçe të BE-së, palët e interesuara ndërkombëtare në Kosovë dhe shoqëria civile kosovare duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e një programi të informimit dhe dialogut publik të bazuar në evidencë, për të adresuar boshllëqet e informacionit, për të kundërshtuar keqinformimin dhe për të nxitur të gjitha palët e interesuara që të përdorin gjuhë të qëndrueshme në lidhje me Gjykatën. Ç'është më e rëndësishmja, se ky program i informimit dhe dialogut publik duhet të shfrytëzojë mesazhe të përshtatura në mënyrë specifike për anëtarët e komuniteteve të ndryshme të Kosovës.

Ky dokument paraqet një grup të qartë dhe të ngushtë të mesazheve të synuara që mund të përdoren për informimin dhe dialog publik rreth Dhomave të Specializuara të Kosovës. Mesazhet që synojnë komunitetet shqiptare dhe serbe, janë zhvilluar respektivisht në lidhje me gjetjet e hulumtimit mbi perceptimin publik të vitit 2017 dhe angazhimit të mëvonshëm me zonat kyçe, dhe testimin rigoroz me fokus grupe mono-etnike. Mesazhet synonohët që të shpërndahen nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, aktorët kyç të BE-së dhe palët e interesuara ndërkombëtare, shoqëria civile kosovare dhe zyrtarët e vetë Gjykatës, duke përdorur një shumëllojshmëri platformash dhe me qëllim (1) të zvogëlimit të rrezikut të keqinterpretimit dhe konfuzionit kur lëshohen aktakuzat e para dhe (2) të gjenerimit e pranimit të gjerë shoqëror të Gjykatës dhe rezultateve të punës së saj në afat të gjatë.

Mesazhet kryesore për qytetarët shqiptar

- Prokurori Special i Kosovës do të ndjekë penalisht personat individualë që kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe krime të tjera që dyshohet se janë kryer gjatë periudhës 1998-2000 dhe që kanë lidhje me pretendimet e ngritura në raportin e Këshillit të Evropës apo të Dik Martit.
- Mandati i Gjykatës mbulon krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, por nuk përfshin krime ekonomike apo korrupsion.
- Gjykata do të ndjekë penalisht kryesit individualë të supozuar. Nuk do ta ndjekë UÇK-në si një organizatë, apo sjelljen e saj gjatë luftës.
- Gjykata Speciale e Kosovës do të luajë një rol të rëndësishëm në avancimin e Kosovës drejt një të ardhme demokratike, multietnike dhe evropiane.
- Gjykata mbështetet nga aleatët kryesorë ndërkombëtarë të Kosovës, të cilët mbështetën iniciativën e Qeverisë së Kosovës për ta themeluar atë dhe tani ajo financohet nga BE-ja, si dhe disa shtete që kontribuojnë, p.sh. SHBA-të.
- Gjykata do të demonstrojë se askush nuk është mbi ligjin, dhe se kryesit e dyshuar do të sillen para drejtësisë, pa marrë parasysh se sa të fuqishëm janë ata sot.
- Gjykata është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të trajtuar të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë, e cila përfshin gjithashtu gjykimet e brendshme të krimeve të luftës në Kosovë dhe Serbi, iniciativat për gjetjen e personave të pagjetur dhe të një Komision të ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin që përfshin të gjitha komunitetet.

- Gjykata nuk do të jetë në gjendje të sjellë drejtësi për të gjitha viktimat, por do ta bëjë këtë për disa viktime dhe familje të viktimave nëse një gjykatës vendos se ata janë viktime të krimeve që mund të sillen para gjykatës.
- Kryesit individualë duhet të mbahen përgjegjës për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që ata kanë kryer. Faji apo pafajësia e një kriminel individual nuk reflekton domosdoshmërisht për shkakun për të cilin ata luftuan.
- Gjykata përpiqet të përmbushë standardet më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ka mësuar nga përvojat e kaluara të Tribunaleve si p.sh. të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë që luftuan për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Ndjekja e krimeve të luftës është e rëndësishme për ndërtimin e besimit në institucionet shtetërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Është në interes të Kosovës të merret me të gjitha krimet e dyshuara të luftës, edhe nëse vendet e tjera nuk bëjnë të njëjtën gjë; me shpresë, Kosova do të japë një shembull se vendet si Serbia do ta ndjekin.
- Sigurimi se kriminelët e luftës janë përgjegjës do të avancojnë perspektivat e Kosovës për t'iu bashkuar BE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- Suksesi i Dhomave të Specializuara të Kosovës do të përmirësojë imazhin ndërkombëtar të Kosovës si një vend që merr sundimin e ligjit seriozisht, pa marrë parasysh sa e dhimbshme apo e vështirë mund të jetë.
- Rezultatet e punës së Gjykatës Speciale të Kosovës në asnjë mënyrë nuk do të dëmtojnë njohjen ekzistuese ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Mesazhet kryesore për qytetarët serbë

- Prokurori Special i Kosovës do të ndjekë penalisht personat individualë që kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe krime të tjera që dyshohet se janë kryer gjatë periudhës 1998-2000 dhe që kanë lidhje me pretendimet e ngritura në raportin e Këshillit të Evropës apo të Dik Martit. Kjo mund të përfshijë anëtarë individualë të UÇK-së.
- Mandati i Gjykatës mbulon krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, por nuk përfshin krime ekonomike apo korrupsion.
- Gjykata do të ndjekë penalisht kryesit individualë të supozuar. Nuk do të provojë UÇK-në si një organizatë, apo sjelljen e saj gjatë luftës.
- Gjykata është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të trajtuar të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë, e cila përfshin gjithashtu gjykimet e brendshme të krimeve të luftës në Kosovë dhe Serbi, iniciativat për gjetjen e personave të pagjetur dhe të një Komision të ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin që përfshin të gjitha komunitetet.
- Gjykata nuk do të jetë në gjendje të sjellë drejtësi për të gjitha viktimat, por do ta bëjë këtë për disa viktime dhe familje të viktimave nëse një gjykatës vendos se ata janë viktime të krimeve që mund të sillen para gjykatës.
- Kryesit individualë duhet të mbahen përgjegjës për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që ata kanë kryer. Faji apo pafajësia e një krimineli individual nuk reflekton domosdoshmërisht për shkakun për të cilin ata luftuan.

- Gjykata përpiqet të përmbushë standardet më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ka mësuar nga përvojat e kaluara të Tribunaleve si p.sh. të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë që luftuan për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Dhomat e Specializuara të Kosovës janë të rëndësishme jo vetëm për të ofruar drejtësi për viktimat, por edhe për të ndihmuar njerëzit në Kosovë që të kuptojnë të kaluarën. Ka kryerës dhe viktimë nga të gjitha anët, dhe të gjithë ata që kanë kryer krime duhet të mbahen përgjegjës.

Mesazhet e synuara në këtë dokument janë prodhuar si pjesë e programit *Dialogu publik dhe angazhim rreth Gjykatës Speciale të Kosovës - Faza 2* e zbatuar nga:

Integra

Integra është organizatë e formuar nga një grup njerëzish të zotuar që të kontribuojnë për mëkëmbjen dhe zhvillimin e Kosovës dhe të rajonit. Puna Integra-s udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë dhe gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga etnia, raca, feja, gjinia, orientimi seksual ose përkatësia politike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin e një Kosove demokratike dhe tolerante, plotësisht të integruar në bashkësinë evropiane.

www.ngo-integra.org | info@ngo-integra.org

Qendra për Paqe dhe Tolerancë

Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT) është organizatë jofitimprurëse joqeveritare, e themeluar me qëllim të mbështetjes së forcimit të kapaciteteve të institucioneve vendore në komunat me shumicë serbe të Kosovës dhe avokimit të qeverisjes lokale transparente dhe kosto-efektive. CPT-ja fuqimisht avokon për krijimin e përfaqësimit të shëndoshë dhe efektiv të serbëve të Kosovës në të gjitha nivelet e qeverisjes, dhe për pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës në jetën politike dhe shoqërore në Kosovë.

www.ngocpt.org | cpt.pristina@gmail.com

PAX

PAX është një organizatë holandeze e shoqërisë civile që tubon njerëz me guximin për t'i dalë zot paqes, duke punuar për të ndërtuar shoqëri dinjitoze, demokratike dhe paqësore anembanë globit. Në Kosovë, programi i PAX-it përfshin drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën, si dhe angazhimin afatgjatë në promovimin e marrëdhënieve të mira ndërmjet komuniteteve në veri.

www.paxforpeace.nl | info@paxforpeace.nl